



Rrjeti për Raportimin e K.O.K.SH
Rr. Shefqet Musaraj 14, H1, Ap.19,
1001, Tiranë, Shqipëri

Datë: 19.06.2025

KËRKESE

KËRKUES: Desada Sadiku

Rrjeti për Raportimin e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit në Shqipëri, e regjistruar në gjykatë me vendimin Nr.1885, datë 21.02.2024, përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv, Lindita Çela

DREJTUAR: Bashkisë Konispol

PËR DIJENI: Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, Marinela Hania

OBJEKTI: Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion dokumentacioni

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 190 dt. 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, neni 3 Neni 23 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë Neni 10 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Neni 119 i Paktit Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike, Neni 119.1.b i ligjit nr.8549, dt 11.11.1999 “Për Statusin e Nëpunësit Civil”

Të nderuar drejtues të Bashkisë Konispol,

Desada Sadiku dhe Rrjeti për Raportimin e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit në Shqipëri, ju lutet institucionit tuaj për vënie në dispozicion të dokumenteve/informacioneve zyrtare në lidhje me subjektet, të cilat janë licensuar apo kontraktuar nga institucioni juaj për shfrytësimin e zonave bregdetare.

Më konkretisht:

1. Kërkojmë të vihemi në dispozicion me një listim të plotë të subjekteve apo personave fizikë të kontraktuar nga Bashkia Konispol për të shfrytëzuar zonat e plazheve në të gjithë territorin e saj duke përfshirë dhe njësitë administrative bregdetare – ndarë sipas kolonave me këto karakteristika:
 - a. emri i subjektit/NIPT-i/Adresa ose vendndodhja e plazhit në shfrytëzim/kohëzgjatja e kontratës;
 - b. në variantin kur janë persona emri mbiemri personit/Adresa ose vendndodhja e plazhit nëshfrytëzim/kohëzgjatja e kontratës.
2. Një kopje të kontratave që ka bashkia juaj në zotërim për hapësirat detare, të rërës dhe të plazheve në qytetin tuaj;
3. A keni ndonjë shoqëri aksionare apo shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e cila menaxhon këto plazhe publike apo private?
4. Nse po, si funksionon?

5. Nëse po, pse keni zgjedhur pikërisht këto shoqëri për dhënien e të drejtës dhe caktimin e përgjegjësisë së menaxhimit, administrimit dhe mirëmbajtjes së plazheve publike?
6. Nëse po, sa sipërfaqe të menaxhimit të plazheve publike apo private kanë nën administrim këto shoqëri?

Kjo kërkesë bazohet në ligjin të sipërpërmendur, i cili shprehet:

“Kërkuesit i vihet në dispozicion një kopje e plotë e dokumentit zyrtar, për të cilin kërkon të informohet.”

Duke ju falënderuar paraprakisht për bashkëpunimin, mbetem në pritje të përgjigjes tuaj!

Për çdo komunikim tjetër me qëllim orientimin dhe sqarimin e paqartësive, mund të më kontaktoni edhe në:

Desada Sadiku

Email: desada.sadiku@shteg.org
Nr. Kontaktit: +355685521061





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KONISPOL**

Date 26.05.2025

Lenda: Kthim përgjigje për informacionin e kërkuar datë 25.04.2025

Drejtuar: Rrjeti për Raportime Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit në Shqipëri

Bashkia Konispol ju bën me dije se nuk disponon listë për subjekte apo persona fizik të kontaktuar nga Bashkia Konispol për shfrytëzimin e plazheve në territorin e saj.

Koordinator Për Te Drejtën e Informimit

Marinela Hania